

OSMANI DO T'I DËRGOJË
GJYKATËS KUSHTETUESE
KOMENTE PËR ÇËSHTJEN
E KONSTITUIMIT TË KUVENDIT

FAQE 4-5



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, do t'i dërgojë të martën gjykatës më të lartë të vendit komentet e saj për çështjen e konstituimit të Kuvendit, kanë njoftuar nga Presidenca. Javën e kaluar Gjykata Kushtetuese vendosi masë të përkohshme përmes së cilës ua ndaloi deputetëve të zgjedhur të Kuvendit të ndërmarrin veprime, si dhe ua ndaloi zhvillimin e ndonjë procedure për formimin e qeverisë së re. Njohësit e çështjeve ligjore dhe kushtetuese, konsiderojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese për vendosjen e masës së përkohshme si një veprim të drejtë dhe të domosdoshëm

AKTUALE



TRUMPI SYNON MARRËVESHJE PËR GAZËN "SË SHPEJTI"

F. 2

BAJRAMI: "REPUBLIKA E TRETË" E KURTIT NUK DO TË NDODHË, QEVERIA E TIJ SHËNOI REKORDE NË DËSHTIME

F. 3

RAMA: 65 MIJË QYTETARË TË PRISHTINËS PËR HERË TË PARË ME NGROHJE QENDRORE

F. 3

EKONOMI



AKB-ja: KOMUNA E PRISHTINËS DHE PALLATI I RINISË PO FALIMENTOJNË BIZNESET VENDORE

F. 8

KOSOVA PRANON FLUTURAKET PA PILOT 'PUMA' NGA SHBA-ja

F. 5



KQZ-ja MIRATON FLETËVOTIMET PËR ZGJEDHJET LOKALE, DO TË SHTYPE MBI 3.6 MILIONË FLETËVOTIME

F. 7



RRITET NUMRI I VIZITORËVE NË HOTELE

F. 8

SPORT



KOSOVA TRIUMFON NDAJ SUEDISË ME NJË PARAQITJE TË SHKËLOYER NË PRISHTINË

F. 10

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

TRUMPI SYNON MARRËVESHJE PËR GAZËN “SË SHPEJTI”

UASHINGTON, 8 SHTATOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka lënë të kuptohet se një marrëveshje për Rripin e Gazës mund të arrihet së shpejti për ta siguruar lirin e të gjitha pengjeve që po mbahen nga Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian. Paraprakisht, Trumpi tha se po e paralajmëron “për herë të fundit” Hamasin që t'i pranojë kushtet e marrëveshjes. Duke folur për gazetarë pasi mbërriti në Uashingtonin të dielën mbrëma pas një udhëtimi të shkurtër në Nju-Jork, Trumpi tha se e kishte diskutuar marrëveshjen në avion. “Ne po punojmë për një zgjidhje që mund të jetë shumë e mirë”, tha ai. Ai nuk pranoi të jepte më shumë

hollësi, por shtoi se “do të dëgjoni për të shumë shpejt”. “Po përpiqemi ta përfundojmë këtë, t'i kthejmë pengjet”, theksoi ai. Më herët të dielën, ai e paralajmëroi Hamasin që t'i pranonte kushtet e marrëveshjes, pa dhënë ndonjë shpjegim. “Izraelitët i kanë pranuar kushtet e mia. Është koha që Hamasi t'i pranojë gjithashtu”, shkroi Trump në platformën e tij Truth Social. “E kam paralajmëruar Hamasin për pasojat e mospranimit. Ky është paralajmërimi im i fundit, nuk do të ketë një tjetër!” Hamasi tha më vonë se i kishte pranuar disa ide nga pala amerikane përmes ndërmjetësve, për ta arritur një marrëveshje armëpushimi në Gazë, dhe se po shtjellonte mënyrat për t'i zhvilluar ato ide. As Hamasi nuk dha hollësi për

marrëveshjen e mundshme. Në deklaratën e tij, Hamasi përsëriti gatishmërinë për bisedime për lirin e të gjitha pengjeve në këmbim që “lufta të shpallet shumë qartë e përfunduar” dhe që forcat izraelite të tërhiqen plotësisht nga toka palestineze. Trumpi u tha gazetarëve se mendon se të gjitha pengjet do të kthehen. “Mendoj se do t'i marrim të gjithë”, tha ai. Ai theksoi se disa mund të kenë vdekur tashmë, por se synimi është kthimi i trupave të tyre. Të shtunën “N12 News” e Izraelit raportoi se Trumpi ia ka paraqitur një propozim të ri për armëpushim Hamasit. Sipas marrëveshjes, Hamasi do t'i liron të gjithë 48 pengjet e mbetura në ditën e parë të armëpushimit në këmbim të mijëra të burgosurve palestinezë



në burgjet izraelite dhe do të negocionte përfundimin e luftës gjatë një armëpushimi në enklavë, raportoi N12. Një zyrtar izraelit tha se Izraeli po e “shqyrton seriozisht” propozimin e Trumpit, por nuk dha më shumë hollësi. Lufta në Gazë nisi më 7 tetor 2023, kur Hamasi vrau 1 200

njerëz në jug të Izraelit dhe mori rreth 250 pengje, sipas shifrave izraelite. Prej atëherë, më shumë se 64 000 palestinezë janë vvarë gjatë luftës së Izraelit, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë, e cila është pjesë e qeverisjes së Hamasit dhe e përbërë nga profesionistë mjekësorë.

FRANCA DREJT NJË KRIZE TË RE POLITIKE TEKSA KRYEMINISTRI PËRBALLET ME VOTËBESIM

PARIS, 8 SHTATOR - Franca rrezikon ta humbë kryeministrin e tretë brenda 12 muajve, sepse kryeministri i tanishëm, François Bayrou, e ka kërkuar votëbesimin e Parlamentit, të cilin pritet ta humbë gjatë një seance të hënën pasdite. Kjo pritet të shkaktojë edhe më shumë paqëndrueshmëri për ekonominë e dytë më të madhe të Bashkimit Evropian. Kryeministri centrist, 74 vjeç, i emëruar nga presidenti Emmanuel Macron para më pak se nëntë muajsh, po rrezikon me shpresën se votimi do t'i bashkojë deputetët e ndarë thellësisht të Asamblesë Kombëtare, pas kërkesave të tij për shkurtimin e shpenzimeve publike. Bayrou beson se shkurtimet janë të nevojshme për t'i frenuar deficitin dhe borxhet në rritje të shtetit francez. Por, deputetët e opozitës janë zotuar se do ta shfrytëzojnë rastin për ta rrëzuar



Bayroun dhe Qeverinë e tij pakicë të përbërë nga ministra centristë dhe djathtistë. Shkarkimi i tij do ta detyronte Macronin ta nisë një tjetër kërkim të lodhshëm për ta gjetur zëvendësuesin e tij. Asambleja Kombëtare, e cila ka 577 deputetë, i ndërpreu pushimet verore për ta mbajtur seancën e jashtëzakonshme që kërkoi Bayrou, e cila fillon në orën 15:00 të hënën. Pas një fjalimi të Bayrou, ku pritet të argumentojë se kursimet janë në interesin kombëtar, deputetët do të diskutojnë dhe më pas do të

votojnë pro ose kundër Qeverisë së tij. Deputetët gjithashtu mund të abstenojnë. Bayrou ka nevojë për shumicë votash për, për të mbijetuar. Nëse shumica voton kundër tij, atëherë, në përputhje me Kushtetutën e Franës, Bayrou duhet t'ia paraqesë dorëheqjen Macronit, me çka do ta fusë Francën në një krizë të re. Deputetët e ekstremit të djathtë dhe të majtë, të cilët kanë thënë se do të votojnë kundër Qeverisë së Bayrou, kanë mbi 320 ulëse në Asamblenë Kombëtare, ndërsa centristët dhe aleatët konservatorë kanë 210 sosh, gjë që e bën dukshëm të pamundur për kryeministrin t'i mbijetojë votëbesimit. Bayrou shprehu zhgënjimin të dielën duke thënë se kundërshtarët e hidhur në të dy skajet e spektrit politik janë bashkuar kundër tij. “Ç’kuptim ka të rrëzohet Qeveria? Këto janë

grupe politike që, jo vetëm nuk pajtohem për asgjë, por, edhe më keq, po zhvillojnë luftë të hapur civile kundër njëri-tjetrit”, tha ai në një intervistë për median online Brut. Nëse Bayrou humb, Macroni do të detyrohet sërish të gjejë një pasues që do të punojë në të njëjtin mjedis të brishtë dhe do të përballet me të njëjtat telashe buxhetore që i kanë mundur si Bayroun, ashtu edhe paraardhësit e tij. Edhe vetë Macroni është zotuar se do të qëndrojë në detyrë deri në fund të mandatit, por rrezikon të kthehet në një president pa ndikim në planin e brendshëm nëse paraliza politike vazhdon. Sipas sistemit politik francez, kryeministri emërohet nga presidenti, i jep llogari Parlamentit dhe është përgjegjës për zbatimin e politikave të brendshme, veçanërisht atyre ekonomike.

Presidenti ka pushtet të madh mbi politikën e jashtme dhe çështjet evropiane, si dhe është komandant i përgjithshëm i Forcave të Armatosura. Duke argumentuar se nevojiten shkurtime të mëdha për t'i rregulluar financat publike, Bayrou ka propozuar një kufizim prej 44 miliardë eurosh në shpenzime në vitin 2026, pasi deficitin e Francës vitin e kaluar arriti në 5.8 për qind të prodhimit të brendshëm bruto, pra shumë më i lartë se caku zyrtar i BE-së prej 3 për qind. Franca përballet gjithashtu me një krizë të madhe borxhi. Në fund të tremujorit të parë të vitit 2025, borxhi publik i Francës arriti në 3.346 trilionë euro, ose 114 për qind të PBB-së. Plani i Bayrou, që përfshin heqjen e dy festave zyrtare, është kritikuar ashpër nga rivalët e tij politikë, të cilët tani kanë mundësi të artë për ta rrëzuar atë.

Grossi paralajmëron për rreziqet e

VJEN, 8 SHTATOR - Shefi i Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore, Rafael Grossi, ka paralajmëruar për një botë me mbi 25 shtete me armë bërthamore. “Pa dashur të përhap panik, rreziku i një konflikti bërthamor është më i madh sot sesa në të kaluarën”, ka thënë ai në një intervistë për të përditshmen italiane, La Repubblica. Ai ka sugjeruar se në një pikë 20 deri në 25 shtete do të mund të kenë armë bërthamore, pa

përmendur afate kohore. Aktualisht janë nëntë shtete në botë me armë bërthamore, sipas ekspertëve. “Procesi i çarmatimit apo zvogëlimi i kontrolluar i arsenalit bërthamor është bllokuar”, ka thënë shefi i agjencisë së Kombeve të Bashkuara. “Ato shtete që posedojmë armë bërthamore janë duke prodhuar më shumë sosh, përfshirë Kinën”. Ai e ka tërhequr vërejtjen edhe për rritjen e retorikës



për sulme bërthamore taktike, të cilën e ka përshkruar si shqetësuese. Grossi e ka parë si brengosës edhe synimin e shumë shteteve për blerjen e armëve bërthamore. “Si drejtor i agjencisë, nuk

mund t'i përmendi me emra. Këto janë shtete të rëndësishme në Azi dhe Gjirin Persik. Një botë me 20-25 shtete të pajisura me armë bërthamore është diçka e paparashikueshme dhe e rrezikshme”. Në mesin e nëntë shteteve me armë bërthamore, pesë janë vende anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara - Shtetet e Bashkuara, Rusia, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Kina.

Të tjera shtete janë India, Pakistani, Koreja e Veriut dhe Izraeli, sipas një raporti të Institutit Ndërkombëtar për Kërkime të Paqes, me seli në Stokholm, si dhe gjetjeve prej Fushatës Ndërkombëtare për Braktisje të Armëve Bërthamore. Së bashku, këto vende besohet se i kanë 12 000 armë bërthamore, ndërsa vetëm Shtetet e Bashkuara dhe Rusia i kanë rreth 10 700 prej tyre.

KOSOVA PRANON FLUTURAKET PA PILOT “PUMA” NGA SHBA-ja

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Ministria e Mbrojtjes ka pranuar sistemin e fluturakeve pa pilot AeroVironment RQ-20 Puma, të prokuruar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes programit “Shtet më shtet” Foreign Military Sales (FMS). Këto kapacitete moderne do të shërbejnë për forcimin e aftësive operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës në fushën e vëzhgimit dhe operacioneve ajrore pa pilot. Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, theksoi rëndësinë e këtij zhvillimi, duke deklaruar se pranimi i fluturakeve pa pilot të tipit RQ-20 Puma është një hap i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve të FSK-së në fushën e inteligjencës dhe zbulimit. “Ky

është rezultat i bashkëpunimit të shkëlqyer me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, partneren tonë strategjike dhe të pazëvendësueshme”, tha ministri Maqedonci. Ministri Maqedonci shtoi se ky bashkëpunim është dëshmi e vazhdimësisë së angazhimit të përbashkët për ngritjen dhe modernizimin e FSK-së në përputhje me standardet më të avancuara ndërkombëtare. Kosova synon të blejë edhe armë të tjera nga ShBA-ja. Vitin e kaluar vendi ka bërë kërkesë për blerjen e 200 kundërajrorëve Javelin, e tani është duke bërë pagesën e tyre. FSK-ja aktualisht është në proces të shndërrimit në ushtri. Procesi ka nisur më 2018 dhe pritet të zgjasë dhjetë vjet. Shtetet e Bashkuara e kanë mbështetur nga fillimi transformimin e FSK-së në



ushtri, por jo edhe NATO-ja, e cila insiston që FSK-ja duhet t’u përmbahet detyrave të saj fillestare, si: reagimi ndaj krizave apo mbrojtja civile. Edhe në të kaluarën Kosova ka blerë pajisje ushtarake nga ShBA-ja. Më 2018 në Kosovë kishin ardhur automjete ushtarake amerikane të tipit Humvee. Për

furnizimin me 51 automjete të këtij tipi, Qeveria e Kosovës në vitin 2018 kishte nënshkruar kontratë me kompaninë amerikane AM General. Dy vjet më vonë Kosova bleu edhe automjete të tjera ushtarake nga ShBA-ja, ndërkaq më 2021 qeveria amerikan i dhuroi Kosovës 55 automjete të

tipit ASV (Armored Security Vehicle). Kosova synon që së bashku me Shqipërinë dhe Kroacinë të bëjnë blerje të përbashkëta të armëve amerikane. Vitet e fundit qeveria ka rritur buxhetin për sektorin e mbrojtjes dhe këtë vit buxheti për këtë sektor është 207.8 milionë euro.

BAJRAMI: ‘REPUBLIKA E TRETË’ E KURTIT NUK DO TË NDODHË, QEVERIA E TIJ SHËNOI REKORDE NË DËSHTIME

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, ka reaguar me tone të ashpra ndaj kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, duke e akuzuar se po punon për shkatërrimin e Republikës së 17 shkurtit dhe krijimin e asaj që e quan “Republika e Tretë”. Sipas saj, Kurti synon një republikë ku institucionet janë nën kontrollin e partisë dhe ku vendimet e gjykatave merren vetëm pas aprovimit të tij personal. “Republika e Tretë e Kurtit nuk do të bëhet asnjëherë. Republika jonë shpëton vetëm duke e dërguar Kurtin në shtëpi”, ka shkruar Bajrami në “Facebook”. Ajo ka kritikuar mbledhjen e fundit të Vetëvendosjes, ku Kurti u mandatua për kryeministër, duke e quajtur një “cirk politik” të mbushur me gënjeshtër për



arritje të paqena. Deputetja e LDK-së ka listuar një numër të gjatë të asaj që i quan gënjeshtër sistematike të kryeministrit, duke i kundërshtuar me fakte e shifra. Në lidhje me pandeminë Covid-19, Bajrami thekson se menaxhimi ishte në duart e qeverisë Hoti, ndërsa Kurti, sipas saj, u bë i njohur për

kthimin e 7 milionë eurove donacione për vaksina. Në fushën e energjisë, e akuzon për rritje të çmimeve tri herë gjatë mandatit, për keqmenaxhim dhe për afërsi të njerëzve të tij me bizneset e tregtimit të energjisë. Ajo nënvizon se gjatë kësaj qeverisjeje ka ndodhur rritja më e madhe e çmimeve në histori,

me inflacion kumulativ prej gati 20 % dhe me rritje të shportës bazë të konsumit mbi 60 %. “Qeveria ka rritur të hyrat në kurriz të qytetarëve, duke i shpërndarë si lëmshë pa asnjë efekt në ekonomi”, thekson Bajrami. Në raport me sigurinë dhe politikën e jashtme, ajo kujton se Kosova është vendosur nën masa ndëshkuese, duke humbur qindra miliona euro fonde të BE-së dhe projekte të rëndësishme. Për ekonominë, sipas saj, rritja mbi 10 miliardë euro është rezultat i çmimeve të larta, ndërsa papunësia dhe ikja e fuqisë punëtore janë rritur. Bajrami e quan të remë edhe pretendimin për investime kapitale rekorde, duke theksuar se, sipas Ministrisë së Financave, shpenzimet e projekteve kapitale janë më të ulëta se në vitet 2017-2018 dhe se nuk ka asnjë projekt

madhor të përfunduar. Ajo përmend edhe dështimin për t’i ndërtuar çerdhet e premtuara, mosreformat fiskale dhe mungesën e mbështetjes reale për sektorin privat. Sa iu përket reformave në drejtësi, deputetja thotë se të vetmet ndryshime ishin ato që, sipas saj, lehtësuan arratisjen e të burgosurve dhe ua dhanë të dënuarve mundësinë ta kryejnë dënimin në shtëpi. Ajo e akuzon Kurtin se e ka gjysmën e kabinetit nën hetime, me mbi 2 500 kontrata njëburimore të lidhura gjatë mandatit. Në fund, Bajrami thekson se “rekordet” e vetme të qeverisë Kurti janë në fusha negative, nga importet dhe kostot e energjisë, kontratat njëburimore, nepotizmi dhe korrupsioni, deri te sulmet ndaj gjyqësorit, medieve dhe vendosja e Kosovës nën masa ndëshkuese.

Rama: 65 mijë qytetarë të Prishtinës për herë të parë me ngrohje qendrore

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se mbi 65 mijë banorë të kryeqytetit janë lidhur për herë të parë me sistemin e ngrohjes qendrore të “Termokos”-it. Përmes një videoje të publikuar në “Facebook”, Rama tha se ky është një hap i madh për ta përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve dhe për ta zvogëluar varësinë nga ngrohja me energji elektrike. “Për herë të parë në kryeqytet, 65 mijë

qytetarë të Prishtinës janë lidhur me ngrohjen qendrore. Ndërkohë, 11 zona të reja janë në proces dhe shumë shpejt do të përfitojnë nga ky sistem. Prishtina përtej ngrohjes me rrymë”, u shpreh Rama. Ai theksoi se projekti do të vazhdojë me zgjerimin e rrjetit të “Termokos”-it në lagje të tjera, duke e cilësuar këtë investim si një ndër arritjet më të rëndësishme të kryeqytetit në fushën e energjisë dhe mjedisit.

Më 12 tetor do të mbahen zgjedhjet lokale. Përparim Rama ka vendosur të kandidojë përsëri nga radhët e LDK-së. Në radhët e Lëvizjes Vetëvendosje kandidon Hajrulla Çeku, ndërsa në radhët e Partisë Demokratike të Kosovës Uran Ismaili. Nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është Bekë Berisha, ndërsa nga Partia Socialdemokrate Besa Shahini.





OSMANI DO T'I DËRGOJË GJYKATËS KUSHTETUESE KOMENTE PËR ÇËSHTJEN E KONSTITUIMIT TË KUVENDIT

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, do t'i dërgojë të martën gjykatës më të lartë të vendit komentet e saj për çështjen e konstituimit të Kuvendit, kanë njoftuar nga Presidenca. Javën e kaluar Gjykata Kushtetuese vendosi masë të përkohshme përmes së cilës ua ndaloi deputetëve të zgjedhur të Kuvendit të ndërmarrin veprime, si dhe ua ndaloi zhvillimin e ndonjë procedure për formimin e qeverisë së re. Njohësit e çështjeve ligjore dhe kushtetuese, konsiderojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese për vendosjen e masës së përkohshme si një veprim të drejtë dhe të domosdoshëm

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, do t'i dërgojë të martën gjykatës më të lartë të vendit komentet e saj për çështjen e konstituimit të Kuvendit, konfirmoi të hënën për "Radion Evropa e Lirë" këshilltari i saj për media, Bekim Kupina. Javën e kaluar Gjykata Kushtetuese vendosi njëzëri masë të përkohshme përmes së cilës ua ndaloi deputetëve të zgjedhur të Kuvendit të ndërmarrin veprime, si dhe ua ndaloi zhvillimin e ndonjë procedure për formimin e qeverisë së re. Gjykata e vendosi këtë masë - që do të jetë në fuqi nga 5 deri më 30 shtator - në mënyrë ex officio dhe në bazë të kërkesës së deputetëve të Listës Serbe. Kupina nuk dha hollësi lidhur me përmbajtjen e komenteve që presidentja do t'ia dërgojë nesër Gjykatës Kushtetuese. Por, ai

shtoi se "qëndrimi i presidentes gjithnjë ka qenë se askush nuk duhet të ketë të drejtën t'i bllokojë institucionet, e rrjedhimisht shtetin. Ashtu siç parashihet në nenin 57 (4) të Kushtetutës, realizimi i të drejtave të komuniteteve është i pandashëm nga detyrimi për t'i respektuar ligjet të Republikës së Kosovës dhe për të mos i cenuar të drejtat e të tjerëve". Nëntë deputetët e Listës Serbe dhe deputeti goran Adem Hoxha iu drejtuan Kushtetueses me kërkesë më 30 gusht lidhur me votimin për nënkryetarin serb në Kuvendin e Kosovës. Gjykata theksoi se - pa u vlerësuar dyshimet e ngritura nga Lista Serbe për shkelje kushtetuese në seancat e 26 dhe 28 gushtit - "është e domosdoshme që të ndalohen të gjitha veprimet e mëtejme drejt zgjedhjes së qeverisë dhe vazhdimet të punës së Kuvendit". Ajo shtoi se masën

e vendosi "në mënyrë që të mos cenohen rendi juridik dhe demokratik në Republikën e Kosovës". Ankesa e Listës Serbe - që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar - erdhi pasi kryetari i ri i Kuvendit, Dimal Basha, i hodhi në votim ndaras kandidatët për nënkryetarë të Kuvendit nga komuniteti pakicë joserb dhe serb. Përfaqësuesja nga komunitetet joserbe, Emilija Rexhepi, u zgjodh nënkryetare e Kuvendit. Lista Serbe, e cila në Kuvend ka 9 nga 10 vendet e rezervuara për serbët, këmbënguli ta propozonte vetëm Sllavko Simiqin edhe pasi ai dështoi t'i merrte 61 votat e nevojshme pas tri raundeve të lejuara të votimit. Kur ajo nuk pranoi të propozonte dikë tjetër për nënkryetar, Basha vendosi të hidhte short, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, për të nxjerrë

një emër tjetër nga komuniteti serb. Përveç të gjithë deputetëve të Listës Serbe, për këtë pozitë u propozua edhe Nenad Rashiç nga partia serbe Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, i cili është ministër në detyrë në qeverinë e Albin Kurtit. As Rashiçi nuk i mori votat e nevojshme. Basha e shpalli njëanshëm të përfunduar konstituimin e Kuvendit pavarësisht moszgjidhjes së nënkryetarit të pestë. Në fillim të këtij muaji, Presidenca tha se ekipi ligjor i presidentes po e bënte një analizë lidhur me procesin e konstituimit të Kuvendit, ndërsa Osmani tha ditë më parë se në lidhje me konstituimin e institucioneve të vendit, do të vepronte "në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi". Njohësi i çështjeve ligjore dhe kushtetuese, Vullnet Bugačku nga Instituti Demokratik i Kosovës, e konsideron vendimin e Gjykatës Kushtetuese për vendosjen e masës së përkohshme si një veprim të drejtë dhe të domosdoshëm. "Për të mos lejuar që të ketë veprime të mëtutjeshme procedurale nga aktorët përkatës - rrjedhimisht nga deputetët e

Kuvendit dhe nga presidentja e shtetit", thotë Bugačku për "REL" -in më 5 shtator. Vendimi i Kushtetueses u kritikua i "njëanshëm" nga partia fituese e zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje. "Gjykata Kushtetuese që në krye të herës ka mbajtur anë duke marrë këtë vendim sot. Ndalimi i punës së 120 deputetëve është në kundërshtim të plotë me funksionalizimin e një nga institucioneve më të rëndësishme të shtetit siç është Kuvendi", shkroi IV në një reagim në "Facebook". Dy ditë pas vendimit të gjykatës, Vetëvendosja e propozoi përsëri Kurtin për kryeministër të vendit. Kurti është zgjedhur me votë unanime në mbledhjen e 59 të Këshillit të Përgjithshëm të IV-së të mbajtur të dielën. Në fjalimin e tij, Kurti e kritikoi Gjykatën Kushtetuese për vendimet që i ka marrë gjatë mandatit të tij qeverisës, dhe ato të muajve të fundit lidhur me konstituim të Kuvendit. Kurti e ka quajtur të paarsyeshme masën e marrë nga Kushtetuesja. "Të vetmen dilemë që e kam në këtë situatë është nëse është më shumë absurde, apo më shumë e dëmshme kjo masë 25-ditore. Por, që është edhe shumë absurde, edhe shumë e dëmshme, nuk kam dyshime", tha Kurti të dielën.

KURTI KRITIKON KUSHTETUESEN TEKSA LV-JA E PROPOZON PËR KRYEMINISTËR

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Lëvizja Vetëvendosje (LV) e ka propozuar kryetarin e saj, Albin Kurti, njëherësh kryeministër në detyrë i Kosovës, për një tjetër mandat në krye të qeverisë. Kurti është zgjedhur me votë unanime në mbledhjen e 59 të Këshillit të Përgjithshëm të LV-së.

Lëvizja Vetëvendosje ka fituar më së shumti vota në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë duke fituar 48 ulëse në Kuvendin e Kosovës - të pamjaftueshme për ta formuar vetë qeverinë.

Në fjalimin e tij, Kurti i ka falënderuar anëtarët e partisë për besimin e dhënë, dhe e ka shpalosur programin që e ka quajtur qeverisje të re. Mes të tjerash, Kurti e ka përmendur synimin e vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe NATO.

Në një pjesë të fjalimit, ai e ka kritikuar Gjykatën Kushtetuese për vendimet që i ka marrë gjatë mandatit të tij qeverisë, dhe ato të muajve të fundit lidhur me konstituim të Kuvendit.

LV e ka marrë vendimin për propozim të Kurtit vetëm pak ditë pasi Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka vendosur masë të përkohshme, përmes së cilës ua ndalon deputetëve të ndërmarrin veprime për zhvillimin e ndonjë procedure për formimin e Qeverisë së re të Kosovës.

Masa do të jetë në fuqi nga 5-30 shtator. Ajo është kritikuar nga LV-ja, e cila ka bërë thirrje të ecet përpara me formimin e qeverisë së re.

Teksa e ka propozuar Kurtin, nënkryetari i LV-së, Glauk Konjufca, i ka kritikuar dhe fajësuar partitë e tjera të mëdha shqiptare për krizën institucionale. “Sivjet e pamë përpjekjen më të rrezikshme për mosnjohjen e rezultatit zgjedhor. Me apo ndoshta pa

vetëdije, partitë politike që e kanë shpallur veten kundërshtare të Lëvizjes Vetëvendosje qysh prej certifikimit të zgjedhjeve, janë përpjekur ta thonë vetëm një gjë, vetëm një votë më pak se 50 për qind dhe shteti mbetet pa Kuvend”.

Pse doli Kushtetuesja me vendim?

Gjykata Kushtetuese ka dalë me vendim bazuar në kërkesën e deputetëve të Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar. Kjo parti beson se janë kryer shkelje kushtetuese pasi kryetari i ri i Kuvendit, Dimal Basha nga LV-ja, i ka hedhur në votim ndaras kandidatët për nënkryetarë të Kuvendit nga minoriteti joserb dhe ai serb.

Lista Serbe, e cila gëzon 9 prej 10 ulëseve të rezervuara në Kuvend për minoritetin serb, ka insistuar në emrin e Sllavko Simiqit, por ai nuk i ka siguruar votat e nevojshme.

Më vonë Basha, duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, i ka nxjerrë në votim përmes shortit emrat e të gjithë deputetëve serbë në Kuvend, por asnjëri nuk i ka siguruar 61 votat e nevojshme.

Basha e ka shpallur Kuvendin të konstituuar, ndonëse nuk është zgjedhur edhe nënkryetari i pestë.

Partitë e tjera besojnë se Kuvendi nuk është konstituuar, ndërsa Presidenca e Kosovës ka thënë në fillim të javës se ekipi ligjor po e analizon këtë proces. Kurti e ka quajtur të paarsyeshme masën e marrë nga Kushtetuesja. “Të vetmen dilemë që e kam në këtë situatë është nëse është më shumë absurde, apo më shumë e dëmshme kjo masë 25-ditore.



Por, që është edhe shumë absurde, edhe shumë e dëmshme, nuk kam dyshime”. Ai e ka kritikuar Gjykatën Kushtetuese për ato që i ka quajtur vonesa në marrjen e vendimeve gjatë mandatit të tij, dhe e ka akuzuar këtë institucion si të njëanshëm, përkatësisht të afërt me partitë shqiptare që ishin në opozitë. “Derisa qeveria punon çdo ditë për qytetarët, Gjykata Kushtetuese vazhdon të vonojë vendime jetike, duke bllokuar reforma, duke shkaktuar pasoja të drejtpërdrejta për demokracinë, për qytetarët, për zhvillimin e vendit”. Njohësi i çështjeve ligjore dhe kushtetuese, Vullnet Bugaqku, nga Instituti Demokratik i Kosovës, i ka thënë Radios Evropa e Lirë këtë javë se e konsideron vendimin e Gjykatës

Kushtetuese për vendosjen e masës së përkohshme si një veprim të drejtë dhe të domosdoshëm. Sipas tij, kjo është një masë procedurale që synon të parandalojë çdo pasojë juridike të mundshme, si dhe dëmet që mund të shkaktohen nga veprimet e deputetëve të Kuvendit të Kosovës apo nga presidentja Vjosa Osmani.

Hapat e radhës

Deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë nisur seancën konstituive më 15 prill. Ajo është vazhduar me muaj dhe situata vazhdon të jetë e paqartë. Kushtetuesja ka dalë tri herë me vendime brenda kësaj periudhe. Sapo Kuvendi konstituohet, presidentja e vendit obligohet ta nominojë partinë fituese të zgjedhjeve mandatare për formimin e

qeverisë. Në këtë pikë nuk ekziston një afat i saktë, por vendimet në fuqi përcaktojnë që procesi duhet të zhvillohet “sa më parë që të jetë e mundur”. Kabineti duhet t’i sigurojë votat e 61 deputetëve brenda këtij afati. E nëse kjo nuk ndodh, presidentja është e obliguar që brenda 10 ditëve t’i ftojë në konsultim edhe një herë partitë politike, dhe të vendosë, sipas diskrecionit të saj, për mandataren e re, nëse ajo ia dëshmon se i ka numrat për ta formuar qeverinë. Edhe mandatarja e ardhshme duhet t’i ketë 15 ditë kohë që t’ia paraqesë Kuvendit përbërjen e kabinetit qeveritar. Nëse qeveria nuk formohet as pas 40 ditësh, presidentja duhet të shpallë dekretin për zgjedhjet e reja, që duhet të mbahen dyzet ditë prej shpalljes së vendimit.

KEDS-I PO DYFISHON KAPACITETET E RRJETIT ELEKTRIK NË FERIZAJ

FERIZAJ, 8 SHTATOR - Ferizaj po hyn në një fazë të re të përmirësimit të infrastrukturës energjetike. Aktualisht në qytetin me rritjen më të shpejtë të popullatës dhe ekonomisë në Kosovë është duke u realizuar një projekt madhor i konvertimit të daljeve të rrjetit të shpërndarjes nga 10 kV në 20 kV.

Projekti përfshin gjithsej tetë dalje, duke dyfishuar kështu kapacitetin e furnizimit me energji elektrike për mijëra qytetarë dhe biznese të zonës. Ky investim strategjik synon t’i eliminojë mbingarkesat në rrjet, ta rrisë sigurinë e furnizimit dhe të ofrojë



shërbime shumë më cilësore për konsumatorët. Me përfundimin e projektit

Ferizaj do të ketë një rrjet modern dhe të përgatitur për kërkesat e rritura të konsumit,

duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin ekonomik dhe social të qytetit.

Projekti është planifikuar të përfundojë brenda këtij viti, duke i dhënë Ferizajt një avantazh të ngjashëm me atë që tashmë është realizuar në Prishtinë, ku ky proces ka sjellë rezultate të prekshme në përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Në kuadër të këtij transformimi, në Nënstacionin Ferizaj 2 tashmë janë vendosur kthina të reja të përshtatura me kapacitetin 20 kV. Ky hap është i një rëndësie të veçantë, pasi garanton që rrjeti do të funksionojë në mënyrë të

qëndrueshme dhe pa ndërprerje edhe në kushtet e ngarkesave të larta.

KEDS-i ka njoftuar se ky investim është pjesë e një strategjie afatgjatë për modernizimin e rrjetit të shpërndarjes në gjithë Kosovën. “Përmes tij, jo vetëm që sigurohet furnizim më stabil dhe efikas, por edhe krijohen parakushtet për integrimin e teknologjive të reja dhe burimeve të qëndrueshme të energjisë. Me këtë hap, Ferizaj po t’i bashkohet qyteteve që po përfitojnë nga një infrastrukturë moderne energjetike, duke garantuar shërbim më cilësor dhe perspektivë më të mirë për të ardhmen”, ka njoftuar KEDS-i.

AMERIKA NË KOSOVË

Prof. Agim R. ZOGAJ

Kosova në prioritetet e vizionit të presidentit Trump

Lufta në Ukrainë i ka dhënë fund Rendit të Ri Botëror, të krijuar pas rënies së Murit të Berlinit. Bota, në vazhdimësi po rrëshqet kah krizat, luftërat e reja, të cilat, paraqesin kërcënim të rrezikshëm për paqen anë e mbanë botës. Aleancat diplomatike dhe veçmas ushtarake midis Rusisë, Bjellorusisë, Kinës, Iranit, Indisë e Koresë së Veriut nuk po i kundërvihen vetëm ShBA-së, por drejtpërdrejt Perëndimit. BE-ja ndërsa, në mungesë të unitetit të saj të plotë, nuk po dëshmon se ka fuqi të përballet me këto rreziqe. I vetmi shtet, i vetmi popull i cili, po vazhdon t'i dalë përballë, këtij kërcënimi, është populli amerikan, shteti amerikan, aleati ynë historik. Është fat i madh për kombin shqiptar, veçmas për Shqipërinë dhe Republikën e Kosovës që, në këto përplasjes midis diktaturave, ideologjive të pushtimeve, nisur nga Rusia, dhe aleatët e saj të rinj, Republika e Kosovës është, fuqishëm, në zonën e gjeopolitikës amerikane. Të jesh ndërsa, në sferën e gjeopolitikës amerikane, përkatësisht, në vizionin e Presidentit Trump, siç është kombi ynë, paraqet një epërsi të jashtëzakonshme në botën e cila, gjithnjë e më tepër po kanoset edhe nga përdorimi i arsenalit bërthamor. Ndërsa, çështja e sigurisë nacionale, e integritetit territorial të shtetit tonë, Republikës së Kosovës,



bëhet edhe më imediate, më prioritet kombëtar, kur kemi parasysh politikën agresore të shtetit serb kundrejt Kosovës dhe ndërhyrjet, hibride të Rusisë në Evropën Juglindore. Ditë më parë u bë e ditur se, në mesin e Programeve të Pentagonit është edhe iniciativa në rrafshin e sigurisë, që përfshin Republikën e Kosovës, Shqipërinë dhe Bullgarinë. Administrata amerikane po planifikon të zbatojë Programet afatgjatë të Sigurisë për ndihmë Evropës, duke përfshirë edhe përforsimin e ndihmave amerikane për Krahun Lindor të kontinentit nga sulmi potencial i Rusisë. Ditë më parë, një ish zyrtar i lartë i NATO-së, tha se, pas përfundimit të luftës në Ukrainë, pra, pas fitores eventuale të Rusisë, Putini mund të sulmojë edhe ndonjë shtet anëtar të NATO-së. Këto deklarata, por edhe planet,

programet e Pentagonit dëshmojnë se, Trumpi me të drejtë po kërkon që, Evropa të merr më shumë detyrime, përgjegjësi për mbrojtjen e vetë, pra, duke ndërmarrë më shumë iniciativa, veprime konkrete në planin e mbrojtjes. Kosova, në planin e politikës amerikane, si zonë e sferës së interesit dhe e gjeopolitikës së ShBA, është e privilegjuar si kurrnjëherë më parë. Marrëveshjet më të reja, në fushën e mbrojtjes, janë dëshmi e fuqishme, se, jemi në Projektet e Sigurisë të Pentagonit për rajonin dhe territorin e Kosovës dhe të Shqipërisë.

Programet e Sigurisë të Pentagonit edhe në Kosovë e Shqipëri

Iniciativa e udhëhequr nga Korpusi i Inxhenerisë të ushtrisë amerikane ka për

objektiv zhvillimin, forcimin e infrastrukturës moderne për trupat amerikane dhe partnerët e saj në Evropën Juglindore, Kosovën, Shqipërinë, Bullgarinë dhe vendet tjera. Ky projekt, drejtpërdrejt, në zhvillimet dramatike për sigurinë e rajonit, reflekton angazhimin e fuqishëm të ShBA-së në gjeopolitikën amerikane, sa i përket Evropës Juglindore dhe më gjerë. Projekti, i shndërruar tani më, në Kontratë të posaçme do të përkrah ndërtimin dhe mirëvendosjen e bazave të ushtrisë amerikane, pra, jo vetëm praninë ushtarake të ShBA-së, por edhe veprimtarinë e agjencive të tjera amerikane në rajon, përfshirë edhe Kosovën dhe Shqipërinë, anëtare e NATO-së. Ky Projekt i Pentagonit, sa i përket shtetit tonë, Republikës së Kosovës është me rëndësi të jashtëzakonshme, jo vetëm në

rrafshin e sigurisë dhe integritetit territorial, sepse, ndikon në forcimin e infrastrukturës sonë ushtarake, ndërtimin e objekteve të reja të logjistikës, fusha stërvitore etj. Mbi të gjitha, dhe më e rëndësishmja, ShBA-ja, përmes këtij Projekti të Korpusi të Inxhinierive të ushtrisë amerikane e ka përfshirë Kosovën, territorin e shtetit tonë, si zonë të sigurt të gjeopolitikës amerikane, në radhën e shteteve me investime të drejtpërdrejta ushtarake të aleatit tonë të përbërës, Amerikës. Pra, përmes këtij Projekti të ushtrisë amerikane, Amerika, miku i ynë, shteti i cili, krah luftës së UÇK-së, është më meritori për çlirimin nga sundimi i Serbisë, për themelimin e shtetit të pavarur të Republikës së Kosovës, është mik i përhershëm shtëpie në Kosovë! Institucionet shtetërore të Kosovës, në të gjitha nivelet, duhet t'i konkretizojnë programet e bashkëpunimit me institucionet amerikane, duke filluar nga Qeveria amerikane, Pentagoni, Ministria e sapoformuar e Luftës, dhe institucionet tjera ekonomike, financiare, kulturore, akademike. Gjithsesi, presidenti Trump e ka vizionin më shpresëdhënës, sistemin e vlerave amerikane, për forcimin e marrëdhënieve, të aleancës gjithëpërfshirëse, ShBA - Kosovë dhe Shqipëri! Kosova dhe Shqipëria do ta mbështesin çdo iniciativë që presidenti Trump ta marrë Çmimin Nobël. USA, always, welcome to Republic of Kosova!

POLICIA NË MITROVICËN E VERIUT KONFISKON AUTOMJET DHE PAJISJE TË KUNDËRLIGJSHME

MITROVICË, 8 SHTATOR - Më 5 shtator në rrugën “Knjaz Milos” në Mitrovicë të Veriut, Policia e Kosovës ka hasur një veturë të parkuar “Skoda Octavia”, ngjyrë hiri, me targa të Serbisë. Në këtë veturë kanë qenë të montuara dy kamera profesionale dhe pajisje të GPRS. Vetura në fjalë është sekuestruar dhe me kompani tërheqëse është sjellë në Stacionin e Policisë Mitrovicë Veri. Pas verifikimit në sistemin e PK-së, ka rezultuar se ishte futur në Republikën e Kosovës në vitin 2022. Sipas Ligjit për Automjete 05/L-132, neni 41, qëndrimi i automjetit në Republikën e Kosovës më shumë se tre muaj konsiderohet i kundërligjshëm dhe i njëjti është proceduar për në Doganën e Kosovës për

veprime të mëtejme. “Gjatë një pune hetimore kemi kontaktuar me personin gjegjes ku sot me date 08.09.2025 është paraqitur n ë Stacionin Mitrovicë/ Veri personi i cili deklaron se vetura është e ‘Narodna Banka Srbije’ dhe kjo veturë ishte përdorur me herët për transportimin e pareve nga Serbia në Kosovë. Gjatë kontrollit të detajuar nga zyrtarët policorë, në automjet janë gjetur dy kamera të vendosura, një DVR dhe një ekran i monitorimit të vendosur në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Privatësinë 06/L-082. Për këtë arsye, në vendngjarje janë ftuar përfaqësues të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), të cilët kanë konfiskuar



pajisjen për procedura të mëturjeshe ligjore. Policia e Kosovës rikujton qytetarët se: 1. Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave



Personale dhe Privatësinë 06/L-082, vendosja e kamerave ose pajisjeve të regjistrimit në automjete ose hapësira private pa autorizim dhe pa sinjal

informues për publikun është e ndaluar dhe përbën shkelje të privatësisë. 2. Bazuar në Ligjin për Automjete 05/L-132, neni 41, posedimi dhe qarkullimi i automjeteve me targa të huaja në territorin e Kosovës është i kufizuar dhe i lejuar vetëm në afatet e përcaktuara me ligj. Çdo automjet që tejkalon këto afate konsiderohet i kundërligjshëm dhe ndaj tij ndërmerren masa ligjore, përfshirë konfiskimin dhe procedimin në Doganën e Kosovës. Policia e Kosovës apelon tek qytetarët që të respektojnë legjislacionin në fuqi dhe t'i shmangen veprimeve të kundërligjshme. Çdo shkelje e ligjit do të ndëshkohet me masat e parapara ligjore”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Një serbi i sekuestrohen mbi 20 mijë euro nga Dogana e Kosovës

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Në pikëkalimin kufitar të Jarinjës, në veri të Kosovës, zyrtarët doganorë kanë ndaluar një shtetas të Serbisë, i cili ka tentuar të hyjë në territorin e Kosovës me mbi 20 mijë euro të padeklaruara. Gjatë kontrollit të

automjetit janë zbuluar dhe sekuestruar mjetet monetare të cilat ishin kryesisht në valutën dinar dhe euro. Në bazë të legjislacionit në fuqi të Kosovës, çdo shumë monetare që tejkalon vlerën prej 10 mijë eurosh, në hyrje apo

dalje nga territori i vendit, duhet të deklarohet para zyrtarëve doganorë. Mosdeklarimi i tyre përbën shkelje ligjore. Dogana e Kosovës ka ritheksuar përkushtimin për t'i luftuar kontrabandën financiare, pastrimin e parave dhe

veprimtaritë e tjera të paligjshme që rrezikojnë sigurinë ekonomike të vendit. Veprime të tilla, thuhet në njoftim, janë thelbësore për ruajtjen e stabilitetit fiskal dhe mbrojtjen e tregut të brendshëm.



KQZ-ja MIRATON FLETËVOTIMET PËR ZGJEDHJET LOKALE, DO TË SHTYPË MBI 3.6 MILIONË FLETËVOTIME

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar numrin e fletëvotimeve, broshurave të kandidatëve dhe listave të votuesve që do të shtypen për zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Sipas vendimit, për raundin e parë të garës për kryetarë komunash do të shtypen 1 800 410 fletëvotime, ndërsa po aq edhe për zgjedhjet për kuvendet komunale. Ky numër përfshin fletëvotimet për vendvotimet e rregullta,

për votimin me kusht, për personat me nevoja të veçanta, si dhe rezervat dhe votimin me postë. Në total, KQZ ka paraparë që të shtypen 268 688 fletëvotime më pak sesa numri i përgjithshëm i qytetarëve me të drejtë vote. Kjo shifër përfaqëson një ulje prej rreth 13 % krahasuar me listën e certifikuar të votuesve që numëron 2 069 098 qytetarë. Sipas të dhënave zyrtare, 2 025 105 votues janë të

regjistruar për të votuar brenda Kosovës, ndërsa 43 993 qytetarë kanë të drejtë të votojnë me postë nga jashtë vendit. Procesi i 12 tetorit do të zhvillohet në 938 qendra të votimit me gjithsej 2 625 vendvotime. Prej tyre, 910 qendra do të shërbejnë për votimin e rregullt me 2 571 vendvotime, ndërsa 38 qendra do të jenë të dedikuara për votimin me kusht, me gjithsej 54 vendvotime.

ZGJEDHJET PËR KRYETAR KOMUNE 2025 IZBORI ZA GRADONAČELNIKA 2025		Prishtinë Priština
Votoni	Glasja	
VETËM NJË KANDIDAT	SAMO JEDAN KANDIDAT	
☐	103	MERKUR BEQIRI ALTERNATIVA
☐	105	HAJRULLA ÇEKO Lëvizja VETËVENDOSJE!
☐	111	FATMIR SELIMI
☐	113	PËRPARIM RAMA LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK
☐	128	NEDIME BELEGU Epoka e Hyjneshës në Prishtinë
☐	130	LULZIM SYLA
☐	149	BESA SHAHINI Partia Socialdemokrate PSD
☐	165	AGIM KRASNIQI Prishtina në dorën tënde
☐	174	BEKË BERISHA AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
☐	191	URAN ISMAILI PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK



ISMAILI PREMTON ZGJIDHJE PËR KRIZËN E MBETURINAVE NË PRISHTINË

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Kandidati i PDK-së për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, ka paraqitur zgjidhjen për problemin shqetësues të mbeturinave, duke theksuar se situata aktuale është alarmante. Sipas tij, Prishtina gjeneron rreth 80 mijë tonë mbeturina çdo vit, ndërsa ka në dispozicion vetëm 16

kamionë për t'i mbledhur ato. Për këtë arsye, qytetarët çdo ditë përballen me kontejnerë të stërmbushur, erë të rëndë dhe, siç theksojnë banorët, edhe me shfaqjen e minjve nëpër lagje. Ismaili paraqiti planin e tij për një qytet të pastër 24/7, që përfshin: Shtimin e 60 kamionëve të rinj për

mbledhjen e mbeturinave, vendosjen e 2 100 kontejnerëve të rinj në çdo lagje të kryeqytetit, hapjen e një deponie të re për mbeturina të vëllimshme dhe ndërtimore. “Një Prishtinë e pastër është një Prishtinë me të cilën krenohemi. Ka ardhur koha për jetë normale në qytetin tonë”, tha Ismaili.

OSMANI MERR FTESË NGA PRINCI I ARABISË SAUDITE

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, priti të hënën në takim ambasadorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, Faisal Ghazi Ismail Hifzi. Në takim u diskutua për marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy shteteve dhe përkushtimin e ndërsjellë për thellimin e tyre përmes nxitjes së investimeve ekonomike në Kosovë, mbështetjes së mëtejshme ndërkombëtare për vendin tonë

nga ana e Arabisë Saudite, si dhe rritjes së bashkëpunimit mes qytetarëve të të dyja vendeve. Presidentja Osmani shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Arabisë Saudite, duke ritheksuar përkushtimin e Kosovës për forcimin e mëtejshëm të kësaj miqësie. Ambasadori Hifzi i dorëzoi presidentes Osmani ftesën e Princit të Kurorës dhe kryeministrit të Mbretërisë së

Arabisë Saudite, Lartmadhërisë së Tij Princit Mohammed bin Salman bin Abdulaziz Al Saud, për të marrë pjesë në forumin “Future Investment Initiative” që do të mbahet në Riad. Presidentja falënderoi ambasadorin për ftesën dhe ritheksoi gatishmërinë për ta vazhduar punën e përbashkët me Lartmadhërinë e Tij, me synim thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve.



Përfundoi me sukses festivali i vjeljes së rrushit “Hardh Fest 2025”

RAHOVEC, 8 SHTATOR - Për tri ditë dhe net të paharrueshme u mbajt festivali i vjeljes së rrushit “Hardh Fest 2025”, duke bashkuar, nën ritet e traditës dhe tingujve të

muzikës, vreshtarët, prodhuesit e verës dhe rakisë, bujqit, artistët, krijuesit e rinj dhe vizitorët nga mbarë Kosova, rajoni e bota. “Hardh Fest për tre netë radhazi u bë

adresë për mijëra vizitorë nga Kosova dhe jo vetëm. Shijuan produktet vendore dhe krijuan kujtime të paharrueshme. Faleminderit të gjithëve që ishit pjesë e kësaj

feste të bukur! Ju presim sërish në Hardh Fest 2026, për të vazhduar këtë traditë të mrekullueshme së bashku!”, ka njoftuar komuna e Rahovecit.



Fillojnë punimet për centralin fotovoltaiik Solar4Kosovo

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar për procesin e fillimit të punimeve ndërtimore të projektit Solar4Kosovo I - Centrali Fotovoltaiik i cili financohet nga Bashkimi Evropian/Korniza e Investimeve për Ballkanin

Perëndimor (WBIF), Qeveria Gjermane përmes KfW si institucioni kryesor financiar ndërkombëtar, Banka Evropiane për Investime (BEI) dhe Korporata Energjetike e Kosovës. Sipas njoftimit, punimet ndërtimore do të zhvillohen në zonën afër

Termocentralit Kosova A, që shtrihet në komunën e Obiliqit dhe Fushë-Kosovës. Këto punime kryesisht lidhen me banorët e Kryshevcit (Dardhishtë) dhe lagjes Mërlak në fshatin Kryshevc, komuna e Obiliqit. Më tej thuhet se ky njoftim

bëhet për të siguruar transparencë dhe informim të drejtë për të gjithë përdoruesit e paaautorizuar të tokës, përveç njoftimeve zyrtare dhe tabelave paralajmëruese që do të vendosen në perimetrin e zonës së projektit, e cila do të jetë e rrethuar me gardh sigurie.



NGA 1 815 PREMTIME QË KANË DHËNË 27 KRYETARË TË KOMUNAVE, KANË PËRMBUSHUR 918

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 GUSHT - Instituti GAP ka publikuar në platformën elektronike “Letërnjoftimi i komunave”, vlerësimin përfundimtar rreth përmbyshjes së premtimeve të kryetarëve të komunave të Kosovës për mandatin 2021-2025. Nga gjithsej 1 815 premtime që kanë dhënë 27 kryetarë të komunave, për këtë mandat janë përmbyshur 918 premtime, ndërsa 234 premtime janë gjysmë të përmbyshura, 281 premtime janë të filluara dhe 382 premtime nuk kanë filluar ende së zbatuari. Ashtu si në mandatin e kaluar (2017-2021), kur ishin përmbyshur 51 % e premtimeve, edhe në mandatin aktual shkalla e përmbyshjes mbetet e njëjtë, 51 %. Sipas

fushave, më së shumti janë përmbyshur premtimet në shëndetësi (66 %), arsim (63 %), administratë (58 %) dhe në fushën sociale (55 %), ndërsa më së paku janë përmbyshur premtimet në urbanizëm (34 %), infrastrukturë (37 %) dhe shërbime publike (41 %). Nga 382 premtimet që nuk kanë filluar të përmbyshen, 98 % e tyre janë përgjegjësi e nivelit lokal, ndërsa vetëm 2 % kërkojnë koordinim ndërinstitutional për t’u realizuar. Në krahasim me mandatet e kaluara, mandati 2021-2025 shënon numrin më të madh të premtimeve të dhëna në zgjedhjet lokale. Konkretisht: në mandatin 2007-2009 janë dhënë 129 premtime, në mandatin 2009-2013 janë dhënë 530 premtime, në mandatin 2017-2021 janë dhënë 930 premtime, ndërsa në këtë mandat janë



monitoruar dhe vlerësuar 1 815 premtime. Në fushatën e fundit zgjedhore, Instituti GAP nuk ka evidentuar asnjë premtim zgjedhor në dhjetë komunat e banuara nga

komuniteti serb dhe në komunën e Mamushës për shkak se kandidatët për kryetarë në këto komuna nuk kanë dhënë premtime gjatë fushatës zgjedhore.

Përmes projektit “Letërnjoftimi i komunave”, Instituti GAP do ta vazhdojë monitorimin e përmbyshjes së premtimeve edhe në mandatin e ardhshëm qeverisës 2025-2029.

AKB-ja: KOMUNA E PRISHTINËS DHE PALLATI I RINISË PO FALIMENTOJNË BIZNESET VENDORE

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) reagon ashpër dhe shpreh shqetësimin dhe indignatën e thellë për veprimin arbitrar të komunës së Prishtinës dhe të Pallatit të Rinisë, të cilët më 1 shtator, pa vendim gjyqate dhe në kundërshtim me çdo parim ligjor, kanë mbyllur biznesin “Visari ShPK - VVD”, një kompani me traditë 20-vjeçare dhe kontribuuese e rregullt në pagesën e qirasë dhe tatimeve në Administratën Tatimore të Kosovës. Sipas AKB-së, nga ky vendim i njëanshëm dhe i padrejtë: 25 punëtorë kanë mbetur në rrugë, duke iu mohuar e drejta elementare për



punë dhe mbijetesë. “Biznesit i janë uzurpuar mbi 200 mijë euro, duke i pamundësuar veprimtarinë normale. Rrezikohet falimentimi i markës tregtare ‘Life Style’, një emër i njohur në tregun kosovar. AKB-ja e konsideron këtë akt si shkelje flagrante të ligjit, të drejtave të pronësisë dhe të lirisë së biznesit, duke dëshmuar një arrogancë institucionale të papranueshme dhe dëm të drejtpërdrejtë për ekonominë e vendit. Kërkojmë me urgjencë që: Të hiqet menjëherë dryni dhe të rikthehet biznesi në lokalet ku ka ushtruar aktivitet prej dy dekadash. Komuna e Prishtinës

dhe Pallati i Rinisë të japin llogari për këtë vendim të paligjshëm dhe dëmet e shkaktuara”, thuhet në reagimin e AKB-së. AKB-ja ka theksuar se institucionet qendrore duhet të reagojnë ndaj këtij precedenti të rrezikshëm, ku bizneset mbyllen pa vendim gjyqësor dhe pa respektim të kontratave. “AKB-ja do të përdorë të gjitha mjetet ligjore dhe demokratike për të mbrojtur bizneset tona nga padrejtësitë e tilla, duke mos lejuar që vendimet arbitrare të shkatërrojnë mundin dhe punën e qytetarëve tanë”, theksohet në reagimin e AKB-së.

Rritet numri i vizitorëve në hotele

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat e Hotelerisë për muajin korrik 2025. Në korrik 2025 numri i vizitorëve (vendorë dhe të huaj) në hotele ishte 77 481, prej tyre 34,40 % ishin

vendorë, kurse 65,6 % ishin të jashtëm. Krahasuar me muajin korrik të vitit 2024 (sa ishin 57 447 vizitorë) ka pasur rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 34,9 %.

Numri i net-qëndrimeve ishte 168 202, prej tyre 36,2 % nga vendorët dhe 63,7 % nga të huajt. Numrin më të madh të vizitorëve të brendshëm në hotele e ka rajoni i Pejës me 9 208 vizitorë dhe me 25 734

net-qëndrime. Sa iu përket vizitorëve të jashtëm, krahasuar me periudhën paraprake (korrik 2024), ka pasur rritje të tyre për 33,3 %. Në total 50 825 vizitorë të jashtëm, nga të cilët numri



më i madh ishte nga: Shqipëria, Gjermania, Zvicra, Turqia etj.

SHQETËSIM NË SHTETET BALTIKE PËR MANOVRAT NË BJELLORUSI



Një zonë neutrale vetëm rreth 15 metra e gjerë shënon kufirin midis Lituanisë dhe Bjellorusisë, e cila konsiderohet aleate e Rusisë. Rripi i tokës prej 600 kilometrash kufizohet nga dy gardhe metalike. Ai në anën lituaneze është i kurorëzuar me tela me gjemba. Sipër tij janë kamera mbikëqyrjeje që rrotullohen rregullisht nga e majta në të djathtë me zhurmë. Lituania është e shqetësuar për shkeljet e mundshme kufitare, veçanërisht që nga fillimi i sulmit të Rusisë ndaj Ukrainës në shkurt të vitit 2022. Ky shqetësim tani është përkeqësuar nga të ashtuquajturat manovra "Zapad". Në shqip, emri do të thotë "perëndim". Disa dhjetëra mijëra ushtarë nga Rusia dhe Bjellorusia do të marrin pjesë në to nga 12 deri më 16 shtator. Ata do të stërviten me tanke dhe mitralozë, por edhe me raketën e re ruse supersonike Oreschnik, e cila thuhet se mund të pajiset edhe me koka bërthamore. Edhe pse këto ushtrime të përbashkëta janë mbajtur rregullisht që nga viti 2009, ato janë të parat e këtij lloji që nga fillimi i pushtimit të Ukrainës. Në përgjigje, rojet kufitare lituaneze kanë marrë trajnime shtesë në javët e fundit dhe do të kryejnë patrullime shtesë gjatë ushtrimeve, shpjegon gjenerali Rustamas Liubajevs i shërbimit të kontrollit kufitar

të vendit.

"Që nga lufta në Ukrainë, ne e shohim Rusinë edhe më shumë si një agresor potencial", tha ai për DW. "Ne presim shkelje kufitare, për shembull, përmes shfrytëzimit të migrantëve, siç ka ndodhur në të kaluarën". Sipas disa raporteve, Rusia mund të ketë sjellë mijëra migrantë në Bjellorusi në vitin 2022 dhe t'i ketë dërguar ata përtej kufirit në Poloni, ndër vende të tjera. Besohet se Moska dëshiron të destabilizojë vendet evropiane në këtë mënyrë. Për më tepër, Lituania po përgatitet që ushtarët të jenë në gjendje të kalojnë kufirin pa leje ose të dërgojnë dronë në ditët në vijim, sipas Liubajevs: "Ka pasur tashmë disa sulme të tilla hibride". Vendet baltike raportojnë vazhdimisht dronë që shkelin hapësirën e tyre ajrore. Në korrik të këtij viti, dy prej tyre fluturuan nga Bjellorusia në Lituani dhe u rrëzuan. Në gusht, një dron që mbante eksplozivë u rrëzua në Poloni.

Lituania riarmatoset

Ndërkohë, Lituania po demonstroi gjithashtu forcën e saj ushtarake. Në ditët në vijim, ajo do të zhvillojë stërvitjet e veta ushtarake me Poloninë, Estoninë dhe Letoninë, duke përfshirë deri në 40.000 ushtarë. Për më tepër, Lituania planifikon të rrisë buxhetin ushtarak në më shumë se 5 përqind të

produktit të brendshëm bruto (PBB) deri në vitin 2026. Në vitin 2021, buxheti i mbrojtjes ishte ende më pak se 2 përqind e PBB-së.

Linus Kojala, drejtor i Qendrës së Gjeopolitikës dhe Sigurisë, një qendër kërkimore me seli në Vilnius, kryeqytetin lituanez, beson se rreziku është kryesisht afatgjatë. "Rusia na konsideron si territore që duhet të jenë nën kontrollin e Kremlinit", i tha ai DW. "Edhe pse nuk mendoj se Rusia do ta pushtojë Lituaniën në të ardhmen e afërt, ne do të monitorojmë nga afër nëse trupat e stacionuara aktualisht në Bjellorusi do të mbeten atje pas manovrave dhe nëse Moska ndërton infrastrukturë afatgjatë atje që mund të shërbejë si bazë për një skenar sulmi shtatë ose dhjetë vjet më vonë prej tani."

Shqetësimi për skenarë të tillë ka qenë i përhapur midis lituanezëve që nga lufta në Ukrainë, thotë Margarita Šešelgytė, drejtore e Institutit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shkencave Politike në Universitetin e Vilniusit. "Menjëherë pas fillimit të luftës së agresionit rus, shumë donin të emigronin," i thotë ajo DW. "Disa madje pyesnin veten nëse duhet të largoheshin nga vendi me familjet e tyre gjatë manovrave të ardhshme." Në fund të fundit, lufta në Ukrainë filloi në një mënyrë të ngjashme. "Së pari, në fund të

vitit 2021, Rusia dërgoi trupa në kufirin ukrainas për manovra, dhe më pas nuk i tërhoqi ato, kështu që ata më në fund ishin në gjendje të pushtonin Ukrainën në fillim të shkurtit 2022," thekson Šešelgytė.

Megjithatë, edhe politilogia beson se rreziku i një pushtimi rus është më afatgjatë. "Për sa kohë që Ukraina nuk humbet ose nuk nënshkruhet një traktat i keq paqeje, ne jemi pak a shumë të sigurt. Megjithatë, nëse lufta në Ukrainë do të mbaronte në një moment, ne mund të ishim në radhë", beson Šešelgytė.

Shtetet Baltike "janë në të njëjtën barkë"

Vendi fqinj i Bjellorusisë ndan këto shqetësime. Tre shtetet baltike, përfshirë Estoninë, janë "në të njëjtën barkë". "Ne e konsiderojmë veten një njësi kur bëhet fjalë për Rusinë", thotë Karlis Bukovskis, drejtor i Institutit të Çështjeve Ndërkombëtare në Riga, kryeqytetin e Letonisë për DW. Bukovskis flet për një "traumë të përbashkët". "Nëpërmjet Paktit fillimisht sekret Hitler-Stalin të vitit 1939, Gjermania naziste ia la Shtetet Baltike Bashkimit Sovjetik, i cili më vonë pushtoi vendet tona midis viteve 1944 dhe 1991". Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, Rajhu Gjerman dhe Bashkimi Sovjetik i ndanë më pas Shtetet Baltike dhe

Poloninë në një sferë ndikimi gjermane dhe një ruse. Një pjesë e Polonisë do t'i transferohej Gjermanisë. "Kjo është arsyeja pse këto lloj manovrash ushtarake ruse na shqetësojnë të gjithëve", thotë Bukovskis.

Megjithatë, sipas politologut, sot ka edhe arsye për optimizëm: "Vlerësohet se më pak trupa do të marrin pjesë në manovra këtë vit sesa në të kaluarën, ndër të tjera sepse ushtria ruse është e angazhuar në Ukrainë. Për më tepër, sot ka mijëra trupa të NATO-s - nga Britania e Madhe, Gjermania dhe madje edhe Franca - të stacionuara në Detin Baltik. Kjo na jep shpresë. Nuk jemi më vetëm!" Aida dhe Mečislav Tarashkeviči vazhdojnë të kenë frikë nga stërvitjet e ardhshme ushtarake. Çifti ka jetuar për gati dy dekada në njërin nga shtatë shtëpitë në fshatin lituanez Gulbine, vetëm shtatë kilometra larg kufirit me Bjellorusinë. "Stërvitjet ushtarake janë shumë afër, kështu që të gjithë në fshatin tonë janë shumë të shqetësuar. Edhe më shumë sepse shohim se çfarë po bën Rusia në Ukrainë", tha për DW Mečislavi, 59 vjeç, i cili, ashtu si gruaja e tij, punon në një fabrikë lokale mishi pule. Gruaja e tij, Aida, shton: "Nuk e kuptoj pse njerëzit duhet të luftojnë. Ne të gjithë duam të bëjmë jetë normale, të bëjmë punët tona dhe të jetojmë në paqe në shtëpitë tona." (DW)



Kosova U19 triumfon edhe ndaj Shqipërisë

TIRANË, 8 SHTATOR - Kosova U19 ka shënuar fitore edhe në ndeshjen e dytë në kuadër të turneut ndërkombëtar në Tiranë, të organizuar nga Federata Shqiptare e Futbollit. Pas fitores ndaj Moldavisë, të përzgjedhurit e Albert Bunjakut shënuan fitore edhe ndaj Shqipërisë

U19, me rezultat 1:0. Golin e fitores për dardanët U19 e realizoi Medjen Llumnica, në minutën e 74-t. Dy ndeshjet në kuadër të këtij turneu i shërbyen stafit të trajnerëve për ta parë gjendjen e futbollistëve dhe për ta përgatitur ekipin sa më mirë për ndeshjet kualifikuese të

muajit të ardhshëm. “Jam i kënaqur me rezultatin, derisa me lojën me dhe pa top vetëm pjesërisht. Mendoj se kemi bërë një hap të mirë përpara. Nuk është ende gjithçka ashtu siç dua unë, por mendoj se jemi mirë të përgatitur për ndeshjet kualifikuese. Dua ta falënderoj stafin tim dhe

djemtë për angazhimin, kohën dhe energjinë e shfaqur në këto dy ndeshje”, deklaroi përzgjedhësi Albert Bunjaku. “Dardanët” e rinj bëjnë pjesë në Grupin e 12-të në kualifikueset e Evropianit së bashku me Norvegjinë,



Gjermaninë dhe Armeninë. Ndeshjet zhvillohen në Norvegji më 8, 11 dhe 14 tetor 2025.

KOSOVA TRIUMFON NDAJ SUEDISË ME NJË PARAQITJE TË SHKËLQYER NË PRISHTINË

“Epoka e re”

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka shënuar një nga fitoret më të rëndësishme në historinë e saj, duke mposhtur Suedinë me rezultat 2-0 në kuadër të kualifikimeve për Kupën e Botës. Ndeshja u zhvillua në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë, përballë mijëra tifozëve që krijuan një atmosferë elektrizuese gjatë gjithë 90 minutave. Pas një humbjeje të rëndë 4-0 ndaj Zvicrës vetëm tri ditë më parë në Bazel, “Dardanët” u rikthyen me një paraqitje të jashtëzakonshme kundër një prej përfaqësueseve më të respektuara në Evropë. Trajneri i Kosovës, Franco Foda, bëri disa ndryshime në formacion, të cilat dukshëm dhanë rezultat, me skuadrën që u

tregua më e organizuar, më agresive dhe shumë më e motivuar.

Kosova nisi ndeshjen me vetëbesim të lartë dhe loja energjike në mesfushë dhe presioni i lartë në zonën e sudezëve dhanë efekt në minutën e 26-të, kur pas një aksioni të mirë kolektiv, Elvis Rexhbeçaj realizoi golin e parë për Kosovën. Vetëm pak minuta para fundit të pjesës së parë, në minutën e 42-të, ishte sulmuesi kryesor i Kosovës, Vedat Muriqi, ai që dyfishoi epërsinë. Në pjesën e dytë, Kosova luajti me maturi dhe inteligjencë taktike. Përkundër disa përpjekjeve të Suedisë për të rikthyer ndeshjen, mbrojtja e Kosovës funksionoi në mënyrë perfekte, duke mos lejuar asnjë rast serioz për kundërshtarët. Portieri Arijanet Muriç pati një ndeshje relativisht të qetë, ndërsa kapiteni Mërgim Vojvoda



udhëhoqi me siguri prapavijën. Në anën tjetër, Kosova vazhdoi të krijojë raste, kryesisht nëpërmjet kundërsulmeve të

shpejta, por gola të tjerë nuk pati. Me këtë rezultat, Kosova tregon se ka potencial për të garuar denjësisht kundër

ekipeve të mëdha dhe se është në rrugën e duhur për ndërtimin e një skuadre konkurruese në nivel ndërkombëtar.

KOSOVA E SHQIPËRIA NË GRUPIN E NJËJTË PARAKUALIFIKUES NË ‘EUROBASKET 2029’

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll kanë mësuar kundërshtarët e raundit të parë parakualifikues për Eurobasketin e vitit 2029. Të hënën është bërë tërheqja e shortit në Riga të Letonisë, ku është përcaktuar që Kosova të jetë pjesë e Grupit C parakualifikues, i cili përbëhet prej tri kombëtareve. Në këtë grup me Kosovën janë edhe

Kombëtarja e Shqipërisë dhe ajo e Sllovakisë, të cilat do të përballen me ndeshjet vajtje-ardhje. Kosova ishte në vazon e dytë, Shqipëria në të tretën, kurse Sllovakia ishte pjesë e vazos së parë. Në short, gjithsej ishin 10 kombëtare të ndara në katër vazo nga FIBA sipas renditjes botërore, ndërsa vetëm një prej tri grupeve përbëhet prej katër kombëtareve. Raundi i parë i

parakualifikimeve do të luhet në tri dritare, me ndeshjet e para që do të zhvillohen në nëntor të këtij viti, pastaj të dytat në shkurt të vitit të ardhshëm dhe të tretat në periudhën qershor-korrik, po ashtu të vitit të ardhshëm. Datat e ndeshjeve do të përditësohen nga FIBA, ndërsa në rrethin e dytë kualifikues avancojnë tri vendet e para dhe vendi i dytë më i mirë.

ORARI I NDESHJEVE

27 nëntor 2025
Sllovakia-Shqipëria

30 nëntor
Shqipëria-Kosova

27 shkurt 2026
Kosova-Slovakia

2 mars 2026
Shqipëria-Slovakia



2 korrik 2026
Kosova-Shqipëria

5 korrik 2026
Sllovakia-Kosova



Fitore shumë e rëndësishme evropiane e Besa Famgasit

PEJË, 8 SHTATOR - Besa Famgas ka shënuar fitore shumë të rëndësishme të dielën mbrëma në palestrën “Karagaçi” në Pejë. Në kuadër të raundit të parë të Kupës Evropiane për hendbollistë, Besa Famgas e

mposhti skuadrën turke Depsas Enerji me rezultat 39:34. Ekipi pejan që nga fillimi ishte në epërsi. Pas pjesës së parë rezultati ishte 19:16 për Besën. Dallimi u rrit në pesë gola në pjesën e dytë. Ndonëse me fond të limituar të

lojtarëve, Besa Famgas ka shfaqur shpirt luftarak dhe shënoi fitore që ka rëndësi edhe për të ardhmen e këtij klubi me nam. Ali Abdulah Zayan ishte më efikas te Besa Famgasi me 14 gola. Nëntë i shënoi Deniz Terziqi e shtatë

Amar Muqolli. Katër gola i shënoi Jon Vokshi, nga dy Enis Kuleta e Edonis Hajra dhe një e shënoi Ilir Istrefaj. Me 13 pritje u dallua edhe Olt Kabashi. Ndeshja e kthimit është të shtunën e ardhshme në Ankara të Turqisë.

Rrahmani mund të mungojë për një kohë nga fushat e gjelbra

FIRENCE, 8 SHTATOR - Kapiteni Amir Rrahmani u lëndua në përballje me Zvicrën dhe është larguar nga grumbullimi i Kosovës. Napoli është përballur me një problem serioz pas pushimit të ndeshjeve ndërkombëtare, pasi Amir Rrahmani ka pësuar një dëmtim dhe aktualisht po u

nënshtrohet ekzaminimeve mjekësore. Vetëm pas rezultateve të plota do të përcaktohet koha e rikuperimit të mbrojtësit të Kosovës, por tashmë ka sinjale se mungesa e tij mund të zgjasë disa javë. Gazetari i “Sky Sport”, Massimo Ugolini, ka zbuluar se Rrahmani do të mungojë të

paktën në ndeshjen e radhës kundër Fiorentinës në Firence të shtunën mbrëma. Përveç kësaj, ai rrezikon të mos jetë i gatshëm as për dy duelet e tjera të rëndësishme, takimin kundër Manchester Cityt në Ligën e Kampionëve dhe përballjen në Serinë A ndaj Pisës. “Testet mjekësore për ta

përcaktuar kohëzgjatjen e dëmtimit nuk kanë mbërritur ende. Rrahmani patjetër do ta humbasë ndeshjen në Firence dhe ka të ngjarë të jetë jashtë edhe për dy ndeshjet e ardhshme, por presim rezultatet e ekzaminimeve që janë duke u zhvilluar”, ka thënë Ugolini.



Ragip Xhaka: Kur shani Granitin, shani emblemën e krenarisë shqiptare

CYRIH, 8 SHTATOR - Babai i futbollistit të njohur të Zvicrës me origjinë shqiptare, Granit Xhaka, ka reaguar ashpër pas një vale fyerjesh dhe shpifjesh që, sipas tij, janë drejtuar ndaj familjes së tij, veçanërisht ndaj djalit të tij, Granitit. Në një postim të gjatë në “Facebook”, Ragip Xhaka u është drejtuar publikisht kritikëve të Granitit, duke i cilësuar sulmet ndaj tij si “sulme ndaj vetë dinjitetit shqiptar”. “O ju të mjerë, të verbër në zemër dhe në mendje – kur tentoni ta njollosni Granitin, në fakt po e njollosni veten tuaj”, ka shkruar Xhaka në një reagim emocional dhe të drejtpërdrejtë.

Ai kujton kontributin e Granit Xhakës në sport dhe në përfaqësimin me dinjitet të shqiptarëve në arenën ndërkombëtare, duke sjell në vëmendje momente kyçe si ngritja e shqiponjës në Botërorin e Rusisë, zërin e ngritur për Kosovën dhe përkushtimin e tij ndaj identitetit kombëtar. Ragip Xhaka shprehjet e zhgënjyer nga kritikë që, sipas tij, vijnë nga shqiptarët. “Po sulmoni një



shqiptar që kurrë nuk e mohoi prejardhjen e tij. Graniti ka ngritur flamurin kuqezi me krenari dhe ka mbrojtur nderin tonë në çdo dalje publike”, ka shtuar Xhaka. Në fund të reagimit, ai lëshon një mesazh të fuqishëm, duke e konsideruar këtë situatë si një moment reflektimi për të gjithë: “Kur e shani Granitin, nuk po shani vetëm një futbollist. Po shani familjen tuaj, po shani një emblemë krenarie shqiptare.

Sepse Xhakat kurrë nuk janë gjuhëzuar – dhe nuk kanë për t’u gjuhëzuar!”. Granit Xhaka ka qenë shpesh në qendër të vëmendjes jo vetëm për performancën e tij sportive, por edhe për qëndrimet publike mbi identitetin shqiptar dhe çështjen e Kosovës. Pavarësisht prej kritikave, ai mbetet një ndër figurat më të njohura dhe të respektuara të sportit shqiptar në diasporë.

Zeneli vendosi me zemër për Suedinë

BORAS, 8 SHTATOR - Besfort Zeneli ka treguar se arsyeja pse e refuzoi Kosovën ishte se zemra e tij rrihte më fort për Kombëtaren e Suedisë. Para se t’i bashkohej Suedisë, Zeneli luajti gjashtë ndeshje për Kosovën U21. 22-vjeçari për herë të parë u ftua te Suedia në muajin mars në dy ndeshjet miqësore ndaj Luksemburgut dhe ndaj Irlandës së Veriut. Mesfushori i Elfsborgut ka tri ndeshje të luajtura për Suedinë, por nuk u ftua për duelet e këtij muaji ndaj Sllovenisë dhe ndaj Kosovës. “Ishte një zgjedhje e vështirë. Mund të kisha luajtur si për



Suedinë ashtu edhe për Kosovën. Në fund, zemra më rrihte më fort për Suedinë dhe pastaj zgjedha atë që më dukej e drejtë në

shpirt. Familja, të afërmit dhe miqtë, të gjithë e mbështetën vendimin tim”, ka thënë ai. Edhe vëllai i madh i Besfortit, Arbër Zeneli, ka dhënë intervistë për mediumet suedeze. Arbëri ka 33 ndeshje të luajtura dhe nëntë gola të shënuara me Kosovën, por që nga viti 2023 nuk është ftuar për “dardanët”. “Albert Bunjaki, atëherë selektor i Përfaqësueses së Kosovës, kishte një vizion për mua me ekipin përfaqësues të parë të Kosovës dhe kjo ishte zgjedhja ime”, ka thënë Arbëri. Sikurse Besforti, edhe Arbëri luan te skuadra e Elfsborgut.

SHKURT

Hamiltoni pas garës në Monza: Po filloj ta kuptoj më shumë makinën e Ferrarit

Lewis Hamiltoni beson se Ferrari ka bërë një paraqitje shumë të mirë në garën e fundit në Monza. Piloti britanik e nisi garën nga vendi i 10 dhe e mbylli në vendin e gjashtë, me një makinë që ishte më kompetitive. “Jam shumë i kënaqur me përparimin që po bëjmë. Po e kuptoj këtë makinë gjithnjë e më mirë. Nuk e di nëse do ta kuptoj ndonjëherë plotësisht, por shpresoj se mund të kontribuoj me makinën e vitit të ardhshëm”, ka thënë Hamiltoni. “Mendoj se mund të kisha bërë edhe më mirë në Monza pa penalizimin në Zandvoort. Kaq shumë energji pozitive këtë fundjavë! E kisha vënë re edhe në të kaluarën, por këtë herë ishte ndryshe në Monza me Ferrarin”, ka deklaruar Hamiltoni.

Fernandes refuzoi tri oferta nga klubet saudite

Kapiteni i Manchester Unitedit, Bruno Fernandes, ka refuzuar tri oferta të mëdha nga klubet saudite këtë verë, sipas “talkSPORT”. Al-Hilal ofroi 100 milionë paund për klubin dhe një kontratë personale prej 200 milionë paundësh për lojtarin, por mesfushori portugez zgjodhi të qëndrojë në “Old Trafford”. Edhe Al Nassri dhe Al Ittihad provuan t’i siguronin shërbimet e tij, por Fernandesi mbeti i palëkundur në vendimin për të ndihmuar në rindërtimin e skuadrës nga “Old Trafford”.

Nagelsmann: Ishte një fitore e rëndësishme

Gjermania ka regjistruar një fitore të rëndësishme me rezultat 3-1 ndaj Irlandës së Veriut, duke u rikthyer te suksesi pas humbjes së pësuar më herët ndaj Sllovakisë. Ndeshja u zhvillua në shtëpinë e gjermanëve dhe fitorja erdhi si një reagim i nevojshëm për ta ruajtur moralin dhe vazhdimësinë në garë. Trajneri i “Die Mannschaft”, Julian Nagelsmann, u shpreh i kënaqur me rezultatin, duke vënë theksin te përmirësimi i skuadrës në pjesën e dytë të ndeshjes. “Po, ishte një fitore e rëndësishme. Morëm tri pikët në ndeshjen tonë në shtëpi. Në pjesën e parë tifozët tanë nuk ishin aq të kënaqur me rezultatin dhe mënyrën se si po luanim, por përmirësua në fraksionin e dytë, ishte një fitore e merituar”, ka deklaruar Nagelsmanni pas përfundimit të ndeshjes. Kjo fitore vjen në një çast vendimtar për Gjermaninë, e cila synon t’i konsolidojë pozitën e saj në grup dhe ta rifitojë besimin e tifozëve.

Ekitike: Nuk më tremb konkurrenca me Isak, ky do të jetë një problem i trajnerit

Hugo Ekitike mezi pret të përballet me konkurrencën e fortë për një fanellë si titullar te Liverpooli pas ardhjes në fundin e merkatos së verës të Alexander Isak. Të dy lojtarët mbërritën në “Anfield” këtë verë për një tarifë

të kombinuar prej 204 milionë eurosh. Ekitike ka shijuar një fillim mbresëlënës në skuadrën e Arne Slot, duke shënuar tre gola në katër paraqitjet e tij të para sezonale në Premierë Ligë, ndërsa tani do të përballet me

konkurrencë të fortë nga Isak në të ardhmen. Kur u pyet për balancimin e minutave midis dy lojtarëve, Ekitike e klasifikoi atë si një problem të trajnerit Arne Slot, që në fund duhet të vendosë për

formacionin. “Kur luan për ekipet më të mira, në mënyrë të pashmangshme pret të konkurrosh me lojtarët më të mirë”, ka thënë Ekitike. “Isak është një lojtar që e kam parë më parë, kështu që është

kënaqësi ta shohësh të vijë. Do të jetë një garë e fortë mes nesh, por unë do të punoj shumë për të qenë i mirë dhe për të performuar mirë. Kështu që, problemi është vetëm i trajnerit”, ka deklaruar Ekitike.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.458/12

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtaren Shpresa Veselaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Zijadin Havolli nga Prishtina, të cilin e përfaqëson me prokurë Selatin Ahmeti avokat nga Prishtina, kundër të paditurve: 1. Afrim Imami dhe 2. Nesrina Imami (trashëgimtarët e te ndjerit Osman Imami) që të dy ish nga Prishtina, tani me adresë të panjohur në SHBA, për vërtetimin e te drejtës se pronësisë, duke vendosur sipas Propozimit të paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurit, jashtë seancës gjyqësore me datën 01.09.2025, mori këtë:

AKTVENDIM

I- Të paditurve 1. Afrim Imami dhe 2. Nesrina Imami, tani me adresë të panjohur i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Hasan Jashari, avokat nga Prishtina, i cili ka për obligim që të paditurit t'i përfaqësoj në procedurën për vërtetim pronësie në lëndën C.nr.458/12.

II- Sipas Dispozitës së nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi i tyre me prokurë, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se ju ka caktuar kujdestarin.

III- Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në Tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Arsyetim

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij, në këtë gjykatë ka paraqitur padi me dt. 05.03.2012, kundër të paditurve: 1. Afrim Imami dhe 2. Nesrina Imami (trashëgimtarët e te ndjerit Osman Imami) që të dy ish nga Prishtina, tani me adresë të panjohur në SHBA, për vërtetimin e te drejtës se pronësisë.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me dt. 25.02.2025 në të cilën seancë ka prezantuar përfaqësuesi me prokurë i paditësit, ndërsa për të paditurit: 1. Afrim Imami dhe 2. Nesrina Imami (trashëgimtarët e te ndjerit Osman Imami) askush nuk ka prezantuar në seancë, andaj me qëllim që çështja të mos zvarritet për shkak të adresës së panjohur të paditurve: 1. Afrim Imami dhe 2. Nesrina Imami, paditësi i propozoi gjykatës që t'ju caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, sipas dispozitës së nenit 79.3 të LPK-së, për të paditurit 1. Afrim Imami dhe 2. Nesrina Imami, tani me adrese të panjohur në SHBA.

Duke vendosur sipas propozimit të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79 par. 3 pika (a) të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurit.

Andaj, gjykata vendosi që të paditurve, t' i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Hasan Jashari avokat nga Prishtina, nga lista e avokatëve të Odës së Avokatëve të Kosovës, i cili do të përfaqësoj interesat e të paditurve në këtë çështje juridiko- civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

C. nr. 458/12 date 01.09.2025.

Gjyqtarja
Shpresa Veselaj



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

[Logo]

REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr. 458/12

THE BASIC COURT OF PRISHTINA – General Department, Civil Division, with judge Shpresa Veselaj in the contested juridical case of the claimant Zijadin Havolli from Prishtina, represented with authorization from Selatin Ahmeti lawyer from Prishtina; against the respondents: Afrim Imami and 2. Nesrina Imami (heirs of the late Osman Imami), both formerly from Prishtina, now with unknown addresses in the USA, regarding the certification of ownership rights, deciding upon the Proposal of the claimant for the appointment of a temporary representative for the respondents, out of a court hearing on 01.09.2025, issues the following:

RULING

I – For the respondents 1. Afrim Imami and 2. Nesrina Imami, who currently have unknown addresses, Hasan Jashari, a lawyer from Prishtina, is appointed as their temporary representative, who is obliged to represent the respondents in the proceedings regarding the certification of ownership in case C.nr.458/12.

II – According to Art. 82 of the Law on Contested Procedure (LCP), the temporary representative has all the rights and obligations of a legal representative, which he exercises until the respondents themselves or their authorized representative appear in court, or until the guardianship authority informs the court that a guardian has been appointed.

III – This ruling shall be published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo, as well as on the Court's Notice Board.

Reasoning

The claimant, through his representative, filed a lawsuit in this court on 05.03.2012, against the respondents: Afrim Imami and Nesrina Imami (heirs of the late Osman Imami), both formerly from Prishtina, now with unknown addresses in the USA, for the certification of ownership rights.

The court scheduled a preparatory hearing on 25.02.2025, in which the claimant's authorized representative appeared, however, for the respondents: 1. Afrim Imami and 2. Nesrina Imami (heirs of the late Osman Imami), no one appeared at the hearing. In order to prevent the case from being delayed due to the unknown addresses of the respondents: 1. Afrim Imami and 2. Nesrina Imami, the claimant proposed to the court that a temporary representative be appointed for the respondents, pursuant to Art. 79.3 of the LCP, for the respondents 1. Afrim Imami and 2. Nesrina Imami, now with unknown addresses in the USA.

Deciding according the proposal of the claimant, the court founds out that there are fulfilled the terms pursuant to art. 79 par. 3 comma (a) of LCP, to assign the temporary representative for the respondents.

Therefore, the court decided for the respondents to be assigned the temporary representative Hasan Jashari, lawyer from Prishtina, from the lawyers' list of Lawyers Chamber of Kosovo, that shall represent the interest of the respondents in this juridical-civil case.

From all the above mentioned, was decided as in the dispositive of the present Ruling.

BASIC COURT OF PRISHTINA
C.nr. 458/12 date: 01.09.2025

JUDGE
Shpresa Veselaj
/Signature/

/Official Stamp: Basic Court of Prishtina /

LEGAL REMEDY: Against the present Ruling appeal is not allowed.

Prishtina, on September 8th, 2025

I attest by my signature below that I have translated the document from Albanian to English accurately to the best of my professional ability.

DENIDA BERISHA
COURT TRANSLATOR
Agjensioni për përkthime "Alfa Com" - Rr. Fazli Grajçevci 7, Prishtinë, Email: ag.alfacom@gmail.com
Tel: +383 (0) 44 584 305; +383 (0) 44 971 325



Prevod sa albanskog na srpski jezik

REPUBLIKA KOSOVO

C. br. 458/12

OSNOVNI SUD U PRIŠTINI - Opšte odeljenje, Građanski odsek, po sudiji Shpresa Veselaj, u parničnoj pravnoj stvari tužioca Zijadin Havolli iz Prištine, koga po punomoćju zastupa Selatin Ahmeti, advokat iz Prištine, protiv tuženih: 1. Afrim Imami i 2. Nesrina Imami (naslednika pokojnog Osmana Imamija), oboje bivših iz Prištine, sada sa nepoznatom adresom u SAD, radi utvrđenja prava svojine, rešavajući povodom predloga tužioca za postavljanje privremenog zastupnika tuženima, van ročišta, dana 01.09.2025. godine, doneo je sledeće:

REŠENJE

I. Tuženima: 1. Afrim Imami i 2. Nesrina Imami, sada nepoznate adrese, postavlja se privremeni zastupnik Hasan Jashari, advokat iz Prištine, koji je dužan da zastupa tužene u postupku radi utvrđenja svojine u predmetu C. br. 458/12.

